



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1472/ 5 prot.

Datë 24.06.2025

V E N D I M
Nr. 808/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.06.2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Pezullimin e procedurës dhe shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-41494-03-18-2025, me objekt “Shërbim për zhvillimin e strategjisë së komunikimit dhe marketingut me publikun”, me fond limit: 14,873,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol

Ankimues:

Operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK me NIPT K71903025A dhe adresë: Rruga Shyqyri Berxolli, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6-të, Nr. 6/5, Dera 28B, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Sh.A Albpetrol, me adresë: Selia, Rruga Fier – Patos, km 7

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.03.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-41494-03-18-2025, me objekt “Shërbim për zhvillimin e strategjisë së komunikimit dhe marketingut me publikun”, me fond limit: 14,873,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.

II.2. Në datën 20.05.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 29.05.2025 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | | | |
|--------------------------------|-------------|------|--------------|
| 1. “Optima Communication” SHPK | 11154999.75 | lekë | kualifikuar |
| 2. “R&T” Advertising | 11820000.00 | lekë | skualifikuar |

II.4. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se në seksionin “Kërkesa” autoriteti kontraktor me datë 29.05.2025 i ka kërkuar operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK paraqitjen e dokumentacionit pranë këtij të fundit me përmbajtje si vijon: *“Nga vlerësimi i procedurës së prokurimit ju si operator ekonomik jeni renditur i pari.*

Mbeshtetur ne nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”,

Ju kërkojmë të dorëzoni pranë AK dokumentat si më sipër brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi.”

II.5. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se në seksionin “Kërkesa” operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK me datë 01.06.2025 i ka kthyer përgjigjen si vijon autoritetit kontraktor: *“Duke ju falenderuar për njoftimin ju bëjmë me dije se brenda afatit që na keni caktuar do të paraqitemi të hënën me datë 02.06.2025 pranë zyrave tuaja për dorëzimin e dokumentave të kërkuara. Mbetemi në dispozicionin tuaj. Faleminderit.”* Gjithashtu vihet re se përgjigjes më sipër operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK i ka bashkëngjitur dokumentin “Shkresë sqaruese shoqëruese për dokumentat e fituesit”.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ konkretisht ankesës së operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK por që është pranuar dhe nga vetë përfaqësuesi i KVO, me datë 02.06.2025 autoriteti kontraktor i ka dërguar e-mail operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK me lëndë “*Sqarim mbi vlerësimin e procedurës me objekt ‘Shërbim për zhvillimin e strategjisë së komunikimit dhe marketingut me publikun’ me REF-41494-03-18-2025*” dhe me përmbajtje si vijon:
Pershendetje,

Pas vleresimit te procedures se prokurimit me objekt “Shërbim për zhvillimin e strategjisë së komunikimit dhe marketingut me publikun” me numër reference REF-41494-03-18-2025, me date 29.05.2025 ne SPE ju ka mbërritur nje mesazh “Kerkese per paraqitje dokumentacioni”. Ju sqarojme se KVO gabimisht gjate kryerjes se vleresimit ne SPE ka kualifikuar oferten tuaj. Arsyet e skualifikimit te ofertes tuaj, gabimisht i jane vendosur nje ofertuesi tjeter pjesmarres ne kete procedure prokurimi. Per kete arsye oferta juaj rezultoi e kualifikuar, kur ne te vertete duhet te rezultonte e skualifikuar. Pas konstatimit te gabimit sot me date 02.06.2025, KVO ka kryer rivleresimin e procedures duke e skualifikuar oferten tuaj. Ne SPE gjeni arsyen e skualifikimit te ofertes tuaj. Per sa me siper, lutemi te mos e merni ne konsiderate mesazhin e derguar per paraqitje dokumentacioni! Duke Ju kerkuar ndjese per kete lapsus, ju urojme pune te mbare! Marsela Pellumbi, ne cilesine e anetarit te KVO.”

II.7. Rerefuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se me datë 02.06.2025 autoriteti kontraktor ka rivlerësuar procedurën dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.	“Optima Communication” SHPK	11154999.75	lekë	skualifikuar
2.	“R&T” Advertising SHPK	11820000.00	lekë	kualifikuar

II.7.1. Operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsye si më poshtë:

OE nuk ka paraqitur Shtojcën 5 “Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit” për stafin, të cilët do të jenë të disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DST.

II.8. Gjithashtu referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se në shkresën shoqëruese të operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK me lëndë “Shkresë sqaruese shoqëruese” rezulton një shënim i lënë me shkrim nga znj. M.P anëtare e KVO në të cilin thuhet se: “Sot me datë 02.06.2025 OE “Optima” ka paraqitur dokumentacionin sipas shkresës shoqëruese, pranë Albpetrol. Ky dokument nuk do të merret në dorëzim pasi OE është sqaruar me e-mail që kërkesa për dokumentacionin është dërguar gabimisht OE, situatë kjo e ndodhur për shkak të një lapsusi njerëzor në vlerësim në SPE.

II.9. Në datën 05.06.2025, është publikuar në SPE njoftimi i fituesit paraprak për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.10. Në datën 09.06.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5396 dhe me nr. 1472 prot., datë 10.06.2025 e operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-41494-03-18-2025, me objekt “Shërbim për zhvillimin e strategjisë së komunikimit dhe marketingut me publikun”, me fond limit: 14,873,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me pezullimin e procedurës dhe vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.11. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim lidhur me arsyet e skualifikimit të ankimuesit.

II.12. Përmes shkresës me nr. 2942/4 prot., datë 17.06.2025 protokolluar me tonën me nr. 1472/2 prot., datë 20.06.2025 me lëndë “Dërgim vendimi mbi ankesën e operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim për zhvillimin e strategjisë së komunikimit dhe marketingut me publikun” me REF-41494-03-18-2025” është dërguar vendimin nr.2942/2 prot., datë 17.06.2025 i zyrtarit të caktuar për shqyrtimin e ankesës (ZSHA) protokolluar me tonën me nr.1472/2 datë 20.06.2025 i cili ka vendosur mospranimin e ankesës duke argumentuar si vijon: “ARSYETIMI I ZSHA:

Nga shqyrtimi i ankimit, vërehet se kjo është një procedure e hapur për shërbime me objekt "Shërbim për zhvillimin e strategjisë së komunikimit dhe marketingut me publikun"

Duke u referuar në zhvillimin e këtij procesi, vërehet se fillimisht, Ankuesi figuronte në sistem si i kualifikuar për vijimësinë e procedurave të mëtejshme, por sipas KVO rezulton se Ankuesi nuk e ka plotësuar "shtojcën 5" të DST.

Në termat e referencës së procedures, si dhe në shtojcat perkatese (pjesë përbërëse të DST), është kërkuar që ofertuesit ndër të tjera, të realizojnë edhe "hartimin e strategjisë së marketingut" për një kompani kombëtare prodhimi naftë sic është shoqëria Albpetrol Sh.A.

Në referimin e përgjithshëm të praktikave për hartime të strategjive të institucioneve të një niveli kombëtar, si dhe referuar vetë materialeve strategjike të publikuara nga institucione të tilla, hartimi i një strategjie komunikimi dhe marketingu me publikun është

një shërbim me natyrë tërësisht intelektuale, ku nuk mbizotërojnë thujasë aspak aspektet fizike të veprimtarisë, por ato aspekte, të cilat kërkojnë ekspertizë të posaçme e të thelluar. Vlen të sqarohet në këtë kontekst se Kontratat, apo shërbimet me natyrë intelektuale mund të jenë kontrata për hartimin e projekteve të ndryshme, pavarësisht kohës fizike që do t'i duhet specialistëve përkatës për hartimin e tyre, qofshin këta inxhinierë projektues, apo edhe regjizorë. Nisur nga ky kontekst, edhe termit e referencës që përshkruhen në formularët e DST, janë të tilla që të krijojnë mundësitë tek ofertuesit se ku do të fokusohen për të përmbushur kërkesat e caktuara. Pikërisht për këtë fakt, Strategjia e Marketingut, sikundër çdo strategji për fusha specifike, krijon për ofertuesit obligimin e përfshirjes së ekspertëve të tilla, të cilët në karrierën e tyre profesionale, janë dalluar për ekspertizë të natyrës së ngjashme. Nisur nga ky fakt, emrat e ekspertëve, janë po aq të rëndësishëm, sa edhe e drejta e Autoritetit Kontraktor për të kërkuar ndryshimin e tyre në rast të konfliktit të interesit, duke shmangur çdo pasojë të mundshme në të ardhmen.

Ankuesi ka paraqitur si argument edhe komunikimin me Agjencinë e Prokurimit Publik, të cilës i ka kërkuar sqarim nëse në këtë procedurë duhet plotësuar apo jo shtojca 5 për stafin. Në përgjigjen e APP është referuar baza ligjore se kur plotësohet shtojca, por jo prononcimi nëse është një kriter përjashtues apo jo plotësimi i emrave të ekspertëve në formularin përkatës.

Për sa me sipër pretendimi i ankuesit nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 114 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 102 të vendimit nr. 285, të Këshilli të Ministrave, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ZSHA

VENDOSI:

- 1. Të refuzojë ankesën e paraqitur nga OE “Optima Communicatin” SHPK.*
- 2. Ky vendim i komunikohet titullarit të AK.*
- 3. Kopje e këtij vendimi i njoftohet OE ankimues dhe Komsionit të Prokurimit Publik.”*

II.13. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ nuk rezultojnë të jenë paraqitur argumenta në sistem nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Optima Communication” SHPK mbi vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit me arsyen se: “OE nuk ka paraqitur Shtojcën 5 “Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit” për stafin, të cilët do të jenë të disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DST.” Komisioni i Prokurimit Publik në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përgjithësisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoriteti kontraktor, gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit mbi skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit me arsyen se: “OE nuk ka paraqitur Shtojcën 5 “Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit” për stafin, të cilët do të jenë të disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DST.” KPP vëren se,

III.1.2. Në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në shtojcën nr. 5 është përcaktuar si vijon: “

Shtojca 5.

(¹Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

¹ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

III.1.3. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të ngarkuar nga autoriteti kontraktor në SPE në pikën 2.3.2 të tij argumentimin për të vërtetuar që operatorin ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe cilësi në një numër të caktuar punonjësish e ka paraqitur si vijon: **“Argumentimi:** Kërkesat për punonjës janë kërkuar në bazë të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku nëpërmjet këtij kriteri provohet se operatorët ekonomikë provojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Albpetrol sh.a duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.”

III.1.4. Në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike” pika A, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objektivi kryesor: Përcjellja e mesazhit se shoqëria “Albpetrol” SH.A ka përmirësuar qëndrimet dhe proceset ndaj mjedisit, duke minimizuar ndotjen dhe duke investuar në teknologji të reja për të mbrojtur ambientin.

A.

Përshkrimi sasior i shërbimeve që kërkohen:

1. Realizim i 1 (një) video të përgjithshme korporative për shoqërinë “Albpetrol” SH.A.
2. Realizim i 5 (pesë) videove informuese lidhur me 5 vendburimet e prodhimit të naftës që janë në administrim të “Albpetrol” SH.A.
3. Realizim i 5 (pesë) videove informuese dhe promovuese të Reparteve Prodhuese dhe Shërbimeve të “Albpetrol” SH.A.
4. Realizim i arkivit të përmbajtjes vizuale dhe multimediale për marketingun digital dhe rrjetet sociale për t’u përdorur në të gjithë harkun kohor të 1 (një) viti ku përfshihen:
 - 30 video montazhe
 - 100 fotografi profesionale
 - 120 designe për postime
 Kjo përmbajtje do të përfshijë: Përdorimi i "Stories" dhe "Highlights" për të krijuar kategori të veçanta, si "Mjedisi", "Teknologjia e Re, "Punonjësit Tanë" dhe “Dita në jetën e punonjësve tanë”.

Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital të shoqërisë “Albpetrol” SH.A.

III.1.5. Në shtojcën 8 “Formulari i termave të references” pika A autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objektivi kryesor: Përcjellja e mesazhit se shoqëria “Albpetrol” SH.A ka përmirësuar qëndrimet dhe proceset ndaj mjedisit, duke minimizuar ndotjen dhe duke investuar në teknologji të reja për të mbrojtur ambientin.

A. Përshkrimi sasior i shërbimeve që kërkohen:

1. Realizim i 1 (një) video të përgjithshme korporative për shoqërinë “Albpetrol” SH.A.
2. Realizim i 5 (pesë) videove informuese lidhur me 5 vendburimet e prodhimit të naftës që janë në administrim të “Albpetrol” SH.A.
3. Realizim i 5 (pesë) videove informuese dhe promovuese të Reparteve Prodhuese dhe Shërbimeve të “Albpetrol” SH.A.
4. Realizim i arkivit të përmbajtjes vizuale dhe multimediale për marketingun digital dhe rrjetet sociale për t’u përdorur në të gjithë harkun kohor të 1 (një) viti ku përfshihen:
 - 30 video montazhe
 - 100 fotografi profesionale
 - 120 designe për postime
 Kjo përmbajtje do të përfshijë: Përdorimi i "Stories" dhe "Highlights" për të krijuar kategori të veçanta, si "Mjedisi", "Teknologjia e Re, "Punonjësit Tanë" dhe “Dita në jetën e punonjësve tanë”.
5. Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital të shoqërisë “Albpetrol” SH.A.

III.1.6. Përmes shkresës me nr. 2942/4 prot., datë 17.06.2025 protokolluar me tonën me nr. 1472/2 prot., datë 20.06.2025 me lëndë “Dërgim vendimi mbi ankesën e operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim për zhvillimin e strategjisë së komunikimit dhe marketingut me publikun” me REF-41494-03-18-2025” është dërguar vendimin nr.2942/2 prot., datë 17.06.2025 i zyrtarit të caktuar për shqyrtimin e ankesës (ZSHA) protokolluar me tonën me nr.1472/2 datë 20.06.2025 i cili ka vendosur mospranimin e ankesës duke argumentuar si vijon: “[...] Në termat e referencës së procedures, si dhe në shtojcat perkatese (pjesë përbërëse të DST), është kerkuar qe ofertuesit ndër te tjera, te realizojne edhe "hartimin e strategjisë së marketingut" për një kompani kombëtare prodhimi nafte sic eshte shoqëria Albpetrol Sh.A.

Në referimin e përgjithshem te praktikave per hartime te strategjive te institucioneve të një niveli kombëtar, si dhe referuar vetë materialeve strategjike të publikuara nga institucione të tilla, hartimi i një strategjie komunikimi dhe marketingu me publikun është një shërbim me natyrë tërësisht intelektuale, ku nuk mbizotërojnë thujase aspak aspektet fizike të veprimtarisë, por ato aspekte, të cilat kërkojnë ekspertize te posaçme e te thelluar. Vlen të sqarohet në këtë kontekst se Kontratata, apo sherbimet me natyrë intelektuale mund te jenë kontrata per hartimin projekteve te ndryshme, pavaresisht kohës fizike që do t'i duhet specialistëve perkatës për hartimin e tyre, qofshin këta inxhinieri projektues, apo edhe regjizore. Nisur nga ky kontekst, edhe termat e referencës që pershkruhen ne formularët e DST, janë te tilla që të krijojne mundësitë tek ofertuesit se ku do të fokusohen për të permbushur kërkesat e caktuara. Pikërisht për këtë fakt, Strategjia e Marketingut, sikundër cdo strategji për fusha specifike, krijon për ofertuesit obligimin e perfshirjes së eksperteve të tille, të cilët në karrierën e tyre profesionale, janë dalluar për ekspertiza te natyres së ngjashme. Nisur nga ky fakt, emrat e ekspertëve, janë po aq te rëndesishem, sa edhe e drejta e Autoritetit Kontraktor për te kerkuar ndryshimin e tyre në raste të konfliktit te interesit, duke shmangur cdo pasojë të mundëshme në të ardhmen.[...]”

III.1.7. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.1.8. Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.1.9. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të

zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

III.1.11. Një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Referuar mënyrës së hartimit të dokumentave të tenderit, nga njëra anë në shtojcat përkatëse të specifikimeve teknike dhe termave të referencës është përcaktuar “Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital të shoqërisë “Albpetrol” SH.A.”, ndërsa në anën tjetër duke ju referuar procesverbalit të hartimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim argumentimin e numrit të kërkuar të punonjësve autoriteti kontraktor e ka lidhur në mënyrë të përgjithshme me nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar pa ju drejtuar urdhërimeve të shkronjës dhe pikës përkatëse të kësaj dispozite konkretisht shkronjës “d” të pikës 4 të saj në të cilin përcaktohet në mënyrë eksplicite se “Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë

ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.” Dhe arsyes së skualifikimit të ankimuesit vihet re një lloj konfuzioni i shkaktuar nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu autoriteti kontraktor arsyen e skualifikimit por edhe kthimin e përgjigjes për trajtimin e ankesës e ka lidhur me kontrata shërbimi të natyrës intelektuale dhe jo me kontratat e shërbimit në kuptimin klasik të tyre në të cilat mbizotërojnë aspekte fizike të veprimtarisë dhe që nuk kërkojnë ekspertizë të posacme. Në këtë kuadër duke marrë parasysh mënyrën e hartimit të dokumentave të tenderit ku në shtojcat përkatëse të termave të referencës dhe të specifikimeve teknike është kërkuar “Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital të shoqërisë “Albpetrol” SH.A” i cili në vetvete kërkon shërbime të natyrës intelektuale dhe procesverbalin e argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim në të cilin nuk është specifikuar shkronja dhe pika e dispozitës përkthëse (shkronja “d” pika 4 e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar) që urdhëron plotësimin e deklaratës sipas shtojcës 5 për shërbime të natyrës intelektuale, kjo situatë shkakton konfuzion si te operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave ashtu edhe te organet e vlerësimit të ofertave dhe të shyrimit të ankesave pasi nuk del e qartë nëse jemi para kontratës së shërbimit në kuptimin klasik të saj dhe për të cilin plotësimi i shtojcës nr.5 të DST nuk nevojitet apo kontratës së shërbimit me natyrë intelektuale ku nuk kërkohen aspekte fizike të veprimtarisë dhe ku përballë këtij rasti plotësimi i deklaratës sipas shtojcës nr.5 të DST është kusht. Operatorët ekonomik të interesuar për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit duhet të ofertojnë mbi bazën e kriterëve të sakta dhe të qarta si dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të mund të shprehet mbi përmbushjen e këtyre kriterëve të përcaktuara qartësisht si kusht për kualifikimin e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe Gjykata Europiane e Drejtësisë (GJED) ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka shkaktuar konfuzion në përgatitjen e ofertave dhe në mënyrën e vlerësimit të tyre pasi nuk del e qartë nëse jemi para kontratës së shërbimit në kuptimin klasik të saj apo para kontratës së shërbimit me natyrë intelektuale ku plotësimi i shtojcës nr. 5 sipas përmbajtjes së dokumenteve standarde të tenderit është kusht, duke rënë kështu në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Kështu që, në lidhje me pretendimin e mësipërm të ankimuesit nuk mund të garantohet një mjet ankimi efektiv, pasi KPP nuk mund të shprehet mbi themelin e kërkesave për shkak të konfuzionit të krijuar në përgatitjen e ofertave si dhe në vlerësimin e tyre. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit si dhe secifikimet teknike duhet të përcaktohen të qarta dhe të sakta nga autoriteti kontraktor si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë

prokurimi të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

III.1.12. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, sipas të cilit: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”* Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për shkak të konfuzionit të krijuar nga autotriteti kontraktor në përgatitjen e ofertave dhe në vlerësimin e tyre pasi nuk del e qartë nëse jemi para kontratës së shërbimit në kuptimin klasik apo kontratës së shërbimit me natyrë intelektuale, kjo përbën shkak për anulimin pjesërisht të dokumenteve të tenderit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në kushtet kur autoriteti kontraktor ka vlerësuar jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi duke specifikuar qartë nëse jemi para kontratës së shërbimit në kuptimin klasik të saj apo përpara kontratës së shërbimit me natyrë intelektuale.

Sa më lart, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-41494-03-18-2025, me objekt “Shërbim për zhvillimin e strategjisë së komunikimit dhe marketingut me publikun”, me fond limit: 14,873,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera duke dërguar dokumentet e reja të procedurës së prokurimit të modifikuara sipas konstatimeve të mësipërme.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

